

URDHËR
Nr. 722, datë 14.11.2023

PËR NJË SHITESË NË URDHRIN NR. 386, DATË 26.6.2019,
“PËR DELEGIM KOMPETENCE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 28 e në vijim të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligji 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe pikës 2, të kreut V, të VKM-së nr. 997, datë 10.12.2010, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Pas pikës 1, të shtohet pika 1.1, me përmbajtje si vijon:

“1.1 Përjashtimisht, autorizimet për dërgimin me shërbim për titullarët e institucioneve në varësisë të Ministrisë së Kulturës, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km duhet të kryhet pas miratimit të ministrit të Kulturës/personit të autorizuar prej tij”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator dhe për komunikimin e tij dhe titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti